


Oshënare Kseni. Hierodëshmor Vavila. Oshënar Zosimai. Filoni i Karpasisë. Oshënare Kseni Rusja



E martë, 24 janar 2023 – Shenjtori i ditës.

Oshënare Kseni. Hierodëshmor Vavila. Oshënar Zosimai. Filoni i Karpasisë. Oshënare Kseni Rusja.

– OSHËNARE KSENI –

Oshënare Kseni (shek. i 5-të), e quajtur Eusebia në Pagëzimin e shenjtë, u rrit në gji të një familjeje të krishterë fisnikësh nga Roma. Kur erdhi dita e martesës që prindërit e saj ia kishin imponuar, sado që ajo kishte dëshirë t'ia përkushtonte virgjërinë Jisu Krishtit, u arratis nga shtëpia bashkë me dy nga shërbëtoret e saj dhe u nisën për në Aleksandri. Kur arritën në ishullin Kos, e ndryshoi emrin në Kseni (e huaj) dhe, duke ngritur duart drejt Perëndisë, iu lut t'i dërgonte, ashtu si shën Theklës (24 shtator), një Pavël tjetër, që ta drejtonte në udhën e shpëtimit. Një plak fisnik dhe i nderuar, po me të njëjtin emër, Pavël, iu shfaq dhe e drejtoi në qytetin e Melisas, në Karie.

Këtu i dhuroi për atë vetë dhe për dy shërbëtoret e saj, disa qeli në afërsi të

manastirit ku oshënarja u bë igumene. Në këtë vend, oshënare Kseni bëri një jetë qiellore, duke u ushtruar tej mase, aq sa u frikësuan edhe demonët. Ushqehej një herë në dy-tri ditë me pak bukë, që e ëmbëlsonte me lotët e saj, duke u lutur dhe duke iu shmangur çdo rasti lavdie, u shërbente të varfërve dhe nxënëseve të saj, të cilat shtoheshin gjithnjë nga dita në ditë. Ndërtoi pranë qelisë së saj një kishë kushtuar Shën Stefanit dhe shumë shpejt vendi u bë një manastir i organizuar.

Pasi jetoi me të vërtetë si e huaj, oshënare Kseni fjeti në paqe, duke u lutur për motrat e saj dhe shpirti i saj u nis me gëzim për në atdheun qiellor. Si shenjë që oshënarja ishte pëlqyer nga Perëndia, u shfaq një kryq i ndritshëm, më i shkëlqyer se dielli, i rrethuar nga një kurorë yjesh, që rrethonin një grup tjetër prej shtatë yjesh; ky kryq e ndoqi kortezhin e funeralit të saj dhe u zhduk kur trupi i shenjtore u fut në dhé.

* * * * *

- HIERODËSHMOR VAVILA -

Shën Vavila vinte nga një familje besimtarësh të Antiokisë. Kur i vdiqën prindërit, pasuritë që kishte ua ndau të varfërve dhe jetimëve dhe, në këtë mënyrë, i çliruar nga përkujdesjet e kësaj bote, u largua në male, që të bënte një jetë asketike bashkë me dy nxënësit e tij, Agapin dhe Timotheun. U bë prift dhe më pas shkoi në Romë, ku paganët e etur për gjak kërkuan ta dorëzonin tek autoritetet. U arratis për në Sicili, i ndjekur si gjithnjë nga dy dishepujt e tij besnikë, ku ktheu një numër të madh paganësh me shembullin e virtyteve dhe mësimdhënien e tij të frymëzuar. Qeveritari i ishullit, kur mësoi për suksesin që kishin pasur tre asketët misionarë, i arrestoi dhe urdhëroi t'i torturonin publikisht, në mënyrë që të frikësoheshin të gjithë ata që ishin tërhequr nga predikimi i tyre. Martirët e shenjtë, të kthyer plotësisht vetëm drejt të mirave të përjetshme, u rezistonin me trimëri torturave, dhe populli, në vend që t'i urrente, filloi t'i admironte. Qeveritari ua preu kokat dhe urdhëroi t'ua hidhnin trupat në zjarr. Meqenëse trupat e tyre mbetën të pacenuar nga zjarri, besimtarët erdhën i morën dhe i varrosën në fshehtësi.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)